

19.12.18

P.nr.1630/2016

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit N P nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1133/2015 të datës 28.07.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit Atnor Skoro, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij Avokat B S nga Prizreni, me datë 24.10.2018 publikisht morri dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

N P nga i ati M dhe e ëma R e lindur D i lindur më datë në fshatin Komuna e Prizrenit, tani me banim në Prizren rruga nr.42, ka të kryer shkollën e mesme, argjendar – tani pa punë, i martuar, baba i katër fëmijëve, me numër personal shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

PËR SHKAK

Me datë 08.02.2015, në Prizren në argjendarinë e tij me mbishkrim e cila gjendet në sheshin blen sendet për të cilat ka mundur të di se janë përfituar me kryerjen e veprës penale, në atë mënyrë që nga personat F A dhe A U blen stoli ari dhe atë 1 (një) byzylyk dore, 1 (një) hallkë dore dhe 2 (dy) unaza, kështu që në emër të çmimit ka paguar shumën e të hollave në lartësi prej 900 €.

Kësodore ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPK.

Gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 85, 86, 73 dhe nenit 345 par.2 të KPK i shqipton:

VËREJTJE GJYQSORE

I akuzuari N P ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPK, vepër penale e cila është e rrezikshme dhe e dëmshme, i njëjti nëse sërish kryen vepra të tilla do të dënohet me dënim më të rëndë.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, pasi që i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike – është i pa punë, prandaj lirohet nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore sepse pagesa e tyre do të rrezikon gjendjen material të akuzuarit dhe anëtarëve të familjes.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1133/2015 të datës 28.07.2016, kundër të akuzuarit Nue Pabuca nga Prizreni,

për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit, i njëjti pas konsultimit me mbrojtësin e tij u deklarua se ka kuptuar aktakuzën, nuk e kundërshton provat materiale dhe e ndjen veten fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 08.02.2015, në argjendarinë e cila gjendet në sheshin "1944" në Prizren, i akuzuari N. P. nga personat F. A. dhe A. U. blen stoli ari dhe atë 1 (një) byzylyk dore, 1 (një) hallkë dore dhe 2 (dy) unaza, të cilat ishin përfituar me kryerjen e veprës penale, me ç'rast në emër të çmimit ka paguar shumën e të hollave në lartësi prej 900 €.

Gjykata para se të hap seancën fillestare bëri shikimin e shkresave të lëndës dhe analizën e provave me ç'rast është vërtetuar se provat janë marrë në pajtim me dispozitat e kodit të procedurës penale dhe aktakuzën e prokurorit të shtetit e bëjnë të qëndrueshme dhe e bazuar në ligj. Provat në fjalë me kohë janë parashtruar të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij me qëllim që të njëjtat të kundërshtojnë dhe të parashtroj prova tjera të cilët do të shkojnë në favor të gjendjes faktike dhe mbrojtjes së tij. Mirëpo në seancën fillestare i akuzuari pas konsultimit me mbrojtësin e tij deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat në të cilat mbështete aktakuza dhe e pranon fajësinë për veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPK. Prandaj pasi që i akuzuari në seancën fillestare pranoi fajësisë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht e cila mbështet në fakte dhe prova materiale, të cilat prova i akuzuari nuk i kundërshtoj, gjykata konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 246 të KPPK dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, është kryefamiljar dhe mbajtës i vetëm i familjes, pendimi për kryerjen e veprës penale, premtimi se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla, gjer më tani nuk ka kryer veprë penale, andaj gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lidhur me kryesin dhe veprën e kryer i shqiptoi vërejtje gjyqësore, sepse konsideron se me qortim do të arrihet qëllimi i sanksionit, e bindur se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i qortimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.


Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1630/2016 të datës 24.10.2018

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha



UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimet, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.